


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Gusht, 2021

**Tiranë, më 17 Shtator 2021:** Në Gusht 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 22,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe ulje me 26,0 %, në krahasim me Korrik 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, eksportet në muajin Gusht 2021 u rritën me 18,9 %. Importet e mallrave arritën vlerën 61 mld lekë, duke u rritur me 26,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 15,0 %, në krahasim me Korrik 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, importet në muajin Gusht 2021 u rritën me 23,2 %. Deficiti tregtar i këtij muaji është 37 mld lekë, duke u rritur me 28,8 %, krahasuar me Gusht 2020 dhe duke u ulur me 6,0 %, në krahasim me Korrik 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, deficiti tregtar në muajin Gusht 2021 u rrit me 26,2 %.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tetëmujorin e parë 2021, eksportet e mallrave arritën vlerën 232 mld lekë, duke u rritur me 37,3 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 487 mld lekë, duke u rritur me 29,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 254 mld lekë, duke u rritur me 22,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Gjatë muajit Gusht 2021, në rritjen e eksporteve prej 22,5 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +17,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,0 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,7 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Tekstile dhe këpucë” ka ndikuar negativisht me -8,7 pikë përqindje.

Gjatë muajit Gusht 2021, rritja e eksporteve prej 18,9 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +15,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +3,9 pikë përqindje dhe “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Tekstile dhe këpucë” ka ndikuar negativisht me -5,4 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2021**




Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë rritur me 37,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,8 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +3,8 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Gusht 2021, në rritjen e importeve prej 26,2 %, krahasuar me Gusht 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +6,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +6,3 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,7 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,1 pikë përqindje.

Gjatë muajit Gusht 2021, rritja e importeve prej 23,2 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,6 pikë përqindje, Ushqime, pije, duhan” me +5,1 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,5 pikë përqindje”. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,1 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2021**



Si tetëmujor, importet janë rritur me 29,3 %, krahasuar me tetëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +8,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +4,1 pikë përqindje.

### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Gusht 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2020 janë: Kosova (46,1 %), Gjermania (23,8 %) dhe Maqedonia (61,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (7,5 %) dhe Spanja (13,4 %).

Gjatë këtij tetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (24,9 %), Kosova (55,3 %) dhe Spanja (35,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Ukraina (28,5 %) dhe Rusia (36,5 %).

Në muajin Gusht 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2020 janë: Italia (9,2 %), Turqia (47,5 %) dhe Gjermania (50,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Rusia (6,9 %), SHBA (27,8 %) dhe Zvicra (26,8).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (31,4 %), Turqia (48,2 %) dhe Kina (27,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Rusia (8,4 %), Zvicra (25,6) dhe Ukraina (15,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 55,1 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 64,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (23,7 %), Turqia (9,3 %), Gjermania (8,2 %) dhe Kina (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin e parë 2021, me vendet e BE-së zënë 60,7 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 55,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,3 %), Turqia (8,0 %), Greqia (6,9 %) dhe Gjermania (6,8 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Gusht 2021**

Vitet	Muajt	Eksperte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2018	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	Janar– Gusht 18	205	16,2	416	4,1	-211	49,4
2019	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	Janar– Gusht 19	200	-2,5	429	3,2	-229	46,6
2020	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	Janar – Gusht 20	169	-15,4	376	-12,3	-207	45,0
2021	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	Janar– Gusht 21	232	37,3	487	29,3	-254	47,8

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Gusht 2021

	Eksporte				Importe			
	Gusht 2020	Gusht 2021	Janar-Gusht 2020	Janar-Gusht 2021	Gusht 2020	Gusht 2021	Janar-Gusht 2020	Janar-Gusht 2021
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>14.142</b>	<b>15.368</b>	<b>127.347</b>	<b>167.047</b>	<b>26.567</b>	<b>31.248</b>	<b>216.131</b>	<b>269.564</b>
Austri	112	234	944	1.595	589	753	3.575	4.434
Gjermani	1.221	1.512	10.658	12.799	3.594	5.396	28.619	36.155
Greqi	992	1.165	7.933	13.220	3.733	3.862	33.820	36.557
Itali	8.612	7.962	77.484	96.791	11.042	12.054	92.144	121.043
Spanjë	1.091	945	11.083	14.961	978	1.133	6.197	7.329
Kroaci	50	154	1.067	1.821	557	689	4.292	5.070
Të tjera të BE-së	2.063	3.395	18.177	25.859	6.074	7.362	47.483	58.977
Mbretëri e Bashkuar	18	88	471	506	483	421	3.344	4.047
Kinë	238	1.158	3.200	5.287	4.569	4.785	33.119	42.172
Kosovë	2.205	3.222	15.191	23.589	707	968	5.131	7.649
Maqedonia e Veriut	724	1.170	5.291	8.051	705	1.128	5.694	6.824
Rusi	7	-	13	8	987	919	9.904	9.071
SHBA	361	228	1.996	2.990	949	685	5.924	10.873
Turqi	344	340	1.669	3.955	5.076	7.486	36.027	53.401
Ukrainë	23	22	312	223	315	290	2.849	2.398
Zvicër	57	153	518	1.670	848	621	7.021	5.220
Të tjera	1.281	2.007	13.338	19.153	7.001	12.303	51.170	75.422
<b>Gjithsej</b>	<b>19.399</b>	<b>23.756</b>	<b>169.346</b>	<b>232.479</b>	<b>48.207</b>	<b>60.855</b>	<b>376.313</b>	<b>486.642</b>

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Gusht 2021

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 2020	Gusht 2021	Janar-Gusht 2020	Janar-Gusht 2021	Gusht 2020	Gusht 2021	Janar-Gusht 2020	Janar-Gusht 2021
<b>Gjithsej</b>	<b>19.399</b>	<b>23.756</b>	<b>169.346</b>	<b>232.479</b>	<b>48.207</b>	<b>60.855</b>	<b>376.313</b>	<b>486.642</b>
Ushqime, pije, duhan	2.721	2.937	24.613	28.237	9.486	12.545	73.021	82.516
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	2.827	4.388	24.825	44.761	4.651	7.883	33.709	46.776
Produkte kimike dhe plastike	757	705	4.774	6.585	7.334	8.355	57.587	73.022
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	92	101	1.321	1.582	817	765	8.080	9.291
Prodhime druri dhe letre	637	737	5.329	5.728	2.164	2.243	15.088	17.376
Tekstile dhe këpucë	7.517	5.834	65.628	72.103	5.250	5.253	45.270	55.692
Materiale ndërtimi dhe metale	2.976	6.354	24.219	48.295	6.011	8.277	50.511	68.594
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	1.154	1.875	13.334	18.293	10.340	13.064	78.675	110.703
Të tjera	717	825	5.303	6.895	2.154	2.469	14.372	22.672

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2021**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
<b>Gjithsej</b>	<b>77.484</b>	<b>96.791</b>	<b>15.191</b>	<b>23.589</b>	<b>11.083</b>	<b>14.961</b>	<b>7.933</b>	<b>13.220</b>
Ushqim, pije duhan	5.701	6.903	2.560	3.052	813	1.004	1.895	2.399
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	805	1.130	2.446	5.496	9.473	13.453	527	4.287
Produkte kimike dhe plastike	1.264	1.789	1.374	2.008	73	19	355	494
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.140	1.115	4	11	71	2	10	10
Prodhime druri dhe letre	3.142	3.756	510	567	3	61	873	867
Tekstile dhe këpucë	49.143	56.411	71	121	505	313	3.264	3.356
Materiale ndërtimi dhe metale	7.584	13.487	6.673	10.364	98	94	747	1.393
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.579	9.061	500	979	26	11	33	66
Të tjera	2.126	3.139	1.052	991	20	2	230	348

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2021**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
<b>Gjithsej</b>	<b>92.144</b>	<b>121.043</b>	<b>36.027</b>	<b>53.401</b>	<b>33.119</b>	<b>42.172</b>	<b>33.820</b>	<b>36.557</b>
Ushqim, pije duhan	12.755	15.679	3.608	4.612	488	649	10.679	10.800
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.162	7.573	2.765	3.690	4	10	5.832	5.095
Produkte kimike dhe plastike	11.956	15.063	5.439	7.249	3.625	6.137	4.995	6.004
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.530	7.531	157	259	368	475	22	23
Prodhime druri dhe letre	3.748	3.958	1.846	2.201	539	480	2.304	2.608
Tekstile dhe këpucë	20.296	26.124	9.305	11.559	5.922	7.341	2.316	2.110
Materiale ndërtimi dhe metale	10.824	15.727	6.651	13.545	4.350	3.516	4.883	6.502
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	19.754	25.063	4.858	7.008	14.467	19.535	1.874	2.198
Të tjera	3.120	4.326	1.398	3.279	3.356	4.030	915	1.216

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## **Përkufizime:**

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## **Shpjegimi i simboleve**

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri